



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2019:276387  
Datë: 04.04.2024  
Numri i dokumentit: 05543612

**K.Dh.Sh.II.nr.860/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Administrativ, KA.nr.205/22 të datës 26.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ, KA.nr.205/22, i datës 26.01.2023/08.12.2022, anulohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Administrativ, KA.nr.205/22 i datës 26.01.2023, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A, dhe është anuluar vendimi i të paditurës nr.2868-2/10 i datës 25.07.2011 dhe vendimi nr.621-2/09 i datës 28.01.2011 të nxjerra nga i padituri Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si të kundërligjshme.

Kundër aktgjykimit të lartcekur në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pala e paditur, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të ndryshohet Aktgjykimi KA.nr.205/22 i datës 26.01.2022, refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i ta paditurës.

Kolegji i kësaj gjykate shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatë me datën, kundër vendimeve të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me nr.2868-2/10 të datës 25.07.2011 me të cilin refuzohet kërkesa e Zyrës Ligjore të KEK Sh.A për rishqyrtimin e vendimit të MMPH-së nr.621-2/2009 të datës 07.02.2011 të ushtruar ndaj MMPH-së, dhe vendimit nr.621-2/9 të datës 28.01.2011 me të cilin aprovohet kërkesa e H.M.M., nga fshati Hade Komuna e Kastriotit / Obiliqit, të ushtruar me datë 16.03.2009 protokoll nr.09/621/1.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimeve të lartcekura të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar dhe e anulon vendimin e kontestuar. Gjykata i vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit sepse vendimi kontestues i të paditurit është në kundërshtim me Aktpajtimin administrativ që KEK Sh.A e ka lidhur me palën në procedurë administrative H.M.M., marrëveshje kjo e lidhur pranë organit administrativ Drejtoratit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ashtu që vendimet kontestuese janë në kundërshtim me nenin 52 të Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve kontestuese në kuptim të nenit 52 të Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative i cili përcakton se: “Andaj duke marrë parasysh këtë fakt, gjykata ka konstatuar se aktpajtimi i cili është lidhur në mes të palëve është në përputhje të plotë me këtë nen dhe ofertën të cilën paraprakisht e ka pranuar pala H.M., pasi që aktpajtimi është lidhur me vullnetin e lirë të palëve dhe nuk ka qenë obligative lidhja e aktpajtimin për palën H.M.M., ashtu që i njëjti është pajtuar që të pranoj kompensimi në afat prej 15 ditëve sipas ofertës së datës 04.02.2008 e cila nuk ka përfshirë koeficientin e zhvendosjes prej 0.1. Ndërlidhur me pretendimet e paraqitura më lartë dhe gjendjen faktike të konstatuar, gjykata vlerëson se vendimet e MMPH janë të kundërligjshme, pasi që procedura administrative në mes palëve është zgjidhur me aktpajtim i cili është ekzekutuar menjëherë nga këtu paditësi, ashtu që pala H.M. ka hequr dorë nga llojet tjera të kompensimit të përcaktuara në vendimin e Qeverisë së Kosovës e të cilat do të mund t’i realizonte në procedurë të rregullt sipas radhës. Andaj ndërlidhur me këtë, gjykata vlerëson se edhe pse Qeveria me vendim të datës 03.11.2004 ka aprovuar kriteret për vlerësimin e pronës dhe pasurisë për banorët e fshatit Hade, Sibovc, Leshkoviç dhe Cerna Vodice të Komunës së Kastriotit/Obiliqit, ky kriter nuk aplikohet dhe nuk gjen zbatim për çështjen e palës H.M., për arsye se kjo çështje është çështje e përfunduar me marrëveshje mes palëve, duke u kompensuar me vetë dëshirë përmes aktpajtimin të lidhur në Drejtoratin për Planifikim, Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit. Gjithashtu, nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata nuk gjeti asnjë provë e cila dëshmon se pronari i patundshmërive H.M.M. është vënë në lajthim gjatë

lidhjes së marrëveshjes më palën paditëse apo se marrëveshja është në dëm të interesit publik ose në dëm të interesave ligjore të personave të tjerë fizikë dhe juridikë, pasi që paraprakisht paditësi i kishte paraqitur edhe ofertën për eksproprijim të pronës dhe marrëveshja e lidhur me datë 19.06.2008 është identike me ofertën e paraqitur, veprime këto në përputhje me nenin 52 të LPA-së. Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me vendimet e kontestuar nga paditësi, ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 të LPA-së si dhe me Marrëveshjen nr. 08.104.2008 të datës 19.06.2008 të lidhur në Drejtoratin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, andaj gjykata bazuar në nenin 46 par.2 të LKA-së vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kolegji i kësaj gjykate duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, vendimet e organit të paditur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe shkresat e tjera të lëndës sipas pretendimeve në ankesë, gjen se aktgjykimi i goditur është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe nga neni 183 e 184 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë. Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore ka konstatuar së, me marrëveshjen e lidhur në mes të KEK Sh.A dhe pronarit H.M.M. nr.08.104.2008 të datës 19.06.2008, nuk është i përfshirë koeficienti i zhvendosjes 10%, i cili është paraparë me vendimin nr.5/119 të datës 03.11.2004, përmes të cilit janë aprovuar kriteret për vlerësimin e pronës të fshatit Hade. Prandaj, Kolegji i kësaj gjykate nuk pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës se shkallës së parë me të cilin ka konstatuar se ky kriter nuk aplikohet dhe nuk gjen zbatim për çështjen e palës H.M., për arsye se kjo çështje është çështje e përfunduar me marrëveshje mes palëve, për arsye se, paditësi gjatë kompensimit të pronës dhe pasurisë H.M., nuk ka zbatuar vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.5/119 të datës 03.11.2004, për shkak se nuk ka bërë kompensimin për koeficientin e Zhvendosjes prej  $k=0.1$  (10%), të pronës dhe pasurisë së H.M.M., i cili koeficient është i paraparë me Kriteret për Vlerësimin të Pronës dhe Pasurisë dhe Aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimit nr.5/119 datë 03.11.2004.

Kolegji vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është përfshi në shkelje esenciale të dispozitave të LKA-së përkatësisht me dispozitën e nenit 21 të LKA-së, përcaktohet se, pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do ti sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthorë. Ngase pala e interesuar H.M.M. me adresë nga Fshati Hade Komuna e Kastriotit nuk ka qenë i përfshirë dhe nuk iu ka dhënë mundësia që të jetë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, të cilat bëjnë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura që ky aktgjykim të mos mund të ekzaminohet, si i tillë se është jo i plotë për faktin se nuk janë dhënë arsye përkitazi me faktet vendimtare. Sepse në këtë çështje juridike, nuk ka qenë i përfshirë pala e interesuar, dhe nuk janë administruar në tërësi provat e nevojshme për faktet kontestuese, për tu vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike dhe për tu aplikuar drejtë dispozitat juridike materiale. Në rastin konkret ky presupozim është plotësuar. Ndërsa me

dispozitën e nenit 37 par. 1 të LKA-së përcaktohet se: nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2 të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji gjykata do t'ia dërgoj nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar. Kurse me dispozitën e nenit 39 par. 1 të LKA-së përcaktohet se gjyqtari mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftoj palët dhe personat e interesuar. Prandaj në rastin konkret nga shkresat e lëndës rrjedh H.M.M. duhet të jetë në cilësinë e palës së interesuar konform dispozitave ligjore të lartcekura të LKA-së.

Gjykata konstaton se ne padi dhe gjate gjithë procesit gjyqësor dhe ne shkresa te lendes ne shkallen e pare shihet qarte se kjo procedurën administrative ishte iniciuar nga pala e interesuar sa i përket te drejtës se tije për kompensimin te koeficientit te zhvendosjes prej 10%, kjo vërtetohet edhe me vendimin Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me te cilin ishte aprovuar kërkesa e H.M.M. e dt 16.03.2009 nr. 09/621/1 dhe vendimin kontestues. Mirëpo edhe përkundër këtyre dëshmime lidhur me palën e interesuar, gjykata nuk e ka ftuar në cilësinë e palës se interesuar ne këtë konflikt administrative, me ç 'rast ka bërë shkelje të dispozitave te LKA-së. Gjykata e shkallës së parë, siç rezulton nga shkresat e lendes dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk ka ftuar palën e interesuar për shqyrtimin e kontestit edhe pse shihet qartë interesi i tij për pjesëmarrje në kontest, pasi ka të drejtë në pjesëmarrje për të mbrojtur interesat të cilat i janë përcaktuar me ligj. Pala e interesuar në konfliktin administrativ është palë, qe do të thotë se gjykata e shkalles së parë është e obliguar që t'ia dërgoj padinë në përgjigje, ajo ka të drejtë që të propozoj nxjerrjen e provave dhe të ndërmarr veprime të tjera në kontest, ka të drejtë që të marr pjesë në shqyrtimin verbal, të deklarohet për të gjitha faktet dhe çështjet juridike, dhe duhet ti dërgohet vendimi gjyqësor. Pala e interesuar gjithashtu ka të drejtë të shfrytëzimit të gjitha mjeteve juridike në konfliktin administrativ. Ajo është e autorizuar, si dhe paditësi, që në mënyrë të pavarur të ndërmarr të gjitha veprimet në kontest nen supozimin se është plotësisht e aftë për ndërmarrjen e veprimeve në kufijtë e aftësive të veprimit. Ne emër të tij veprime në kontest mund të ndërmarr edhe personi i autorizuar për përfaqësimi i palës së interesuar. Prandaj, nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkalles së parë nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar. Meqë në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për këtë, dhe as arsyetim se për çfarë arsye nuk ju kanë njohur këto të drejta dhe dhen mundësia që të jetë palë në procedurë. Prandaj edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht. Si pasojë e këtyre të metave të cekura me lartë, e që janë të tilla, që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë se vendimit të kontestuar, dhe shkeljeve thelbësore të procedurës rezulton se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë, dhe në një gjendje të tillë faktike e drejta materiale nuk është zbatuar drejtë. Për këto arsye, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanoj të metat e lartcekura, të kujdeset që çështja kontestuese të shqyrtohet në tersi, duke ia lejuar dhe njohur të drejtat palës së interesuar si palë në procedurë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, që ti paraqes provat e veta për vërtetimin e pretendimeve të tij. Pra, të bej vërtetimin e të gjitha fakteve të nevojshme dhe rrethanave që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, që theksimet jo të plota të palëve të plotësohen me provat e tyre, si dhe dokumentacioni tjetër të cilin e posedojnë dhe të cilat gjykatës i nevojiten për zgjidhjen e kontestit, nga këto shkaqe aktgjykimi i shkallës së parë, prishet dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Pas mënjanimi të metave të larte cekura, dhe vërtetimit të drejtë dhe

të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejt e të bazuar në prova dhe në ligj në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.860/23, me datë 28.03.2024

Kryetar i kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi